



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot më datë 29.09.2023, në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, nga Njësia e Prokurimit, e përcaktuar në urdhërin e prokurimit nr. 8715 datë 26.09.2023, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, në lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme:

OBJEKTI I PROCEDURËS : “Blerje mobilje zyre për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
39130000-2

VLERA E FONDIT LIMIT :

Fondi limit: 2,329,000 (dy milion e treqind e njëzetë e nëntë mijë) lekë **pa TVSH.**

, vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të Vendimit Nr.126, datë 23.12.2022 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e Buxhetit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, për Vitin 2023.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë** (Njësia e Prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Argumentimi

Sasia e artikujve objekt prokurimi janë hartuar/perciell prane sektorit Te prokurimeve me ane te kerkeses per prokurim **Nr.8338 Prot., datë 14.09.2023**, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Bazuar në nenin 35 dhe 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 13 dhe 76 të V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, komisioni i ngritur në zbatim të **Urdhërit Nr.Prot 8371 (Nr.U 260) datë 18.09.2023**, “Për hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit”, ka hartuar dhe argumentuar specifikimet teknike, sic janë paraqitur në relacionin perkates bashkelidhur DST. Specifikimet teknike jane hartuar sipas kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor dhe kërkesave të bëra nga Sektori përkatës.

Janë mbajtur parasysht standartet duke përshtatur nevojat e institucionit për një performance të lartë dhe trendeve të tregut. Këto specifikime janë përzgjedhur në mënyrë të tillë që ti rezistojnë kohës, me një cilësi relativisht të lartë, të jenë të përshtatshme për ambientet e punës ku ato do të vendosen, dimensionet e këtyre ambienteve dhe kërkesave të stafit të AK (pas konsultimeve me ta)

Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit dhe përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Grupi i punes per testimin e tregut komisioni i ngritur në zbatim të **Urdhërit Nr.Prot 8371 (Nr.U 260) datë 18.09.2023**, “Për hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e fondit limit”, mbeshtetur ne germen b) pika 1, e *nenit 76, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; , ka përlllogaritur fondin limit duke testuar tregun dhe ka mbajtur procesverbalin mbi vendosjen e fondit limit per procedure me objekt: “Blerje mobilje zyre, për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë” fondi me vlere: 2,329,000 leke pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të Vendimit Nr.126, datë 23.12.2022 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 (ndryshuar me VKB Nr.82 datë 20.07.2023) dhe detajimin e Buxhetit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, për Vitin 2023-2025.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76, si dhe bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: “1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. 2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.” si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, nenit 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 44 pika 7 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit

(Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues.)

Argumentimi:

Përsa më sipër, referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik fitues (i kualifikuar në vënd të parë në SPE) duhet të paraqesi dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vone se 5 dite nga klasifikimi i bërë nga A.K.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. 2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 40 pika 4 dhe 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e kërkuara e cila duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të procedurës objekt prokurimi, është vendosur sipas vlerave të xhiros së parashikuara në rregullat e prokurimit publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në piken 1, te nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2.2 Deklaratë nga Operatori Ekonomik për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se **20 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të e specifikimeve teknike të mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 55, pika 4, b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se **20% e vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.**

2.3.2 Operatorët ekonomik duhet të kenë një punësim mesatar mujor prej të paktën 3 (tre) punonjës gjatë 3 mujorit të fundit, nga data e zhvillimit të kësaj procedure, të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj,
- List pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për secilin muaj.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit dokumentacionin provues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Certifikatë ISO 9001-2015 ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatë ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas aktmarrëveshjes.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 (pikën 1/a dhe 2), nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese autorizim prodhuesi ose autorizim distributori të autorizuar ku të vertetohet lidhja me prodhuesin, për të gjithë mallrat objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe nenin 40, pika 6, germa” a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqese katalogun e prodhuesit/prodhuesve, skeda teknike ku të përshkruhen se përmbushen specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi në përputhje me ato të kerkuara nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe nenin 40, pika 6, germa” b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese një deklaratë të garancisë së mallrave që kërkohen të prokurohen, nepermjet së cilës merr persiper dhe te garantoje: riparimin, mirembajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit për periudhën jo me pak se 2 (dy) vjecare nga koha e marrjes ne dorezim te artikujve nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 4, e LPP, si dhe nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Përsa më sipër, referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik fitues (i kualifikuar në vënd të parë në SPE) duhet të paraqesi dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në original ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vone se 5 dite nga klasifikimi i bërë nga A.K.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Data e zhvillimit të kësaj procedure do të jetë **13.10.2023 ora 10:00** në adresën: www.app.gov.al.

Procesverbali pasi u lexua, u firmos nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit të si më poshtë: